

CITATE
TË KRYETARIT
MAO CE-DUN



SHTËPIA BOTONJËSE E
GJUHËVE TË HUAJA
PEKIN 1967

MESAZH I SHOKUT MAO CE-DUN DREJTUAR KONGRESIT TË 5-të TË PPSH

KONGRESIT TË 5-të TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Të dashur shokë,

Partia Komuniste e Kinës dhe populli kinez i shprehin Kongresit të 5-të të Partisë së Punës të Shqipërisë përshëndetjet më të nxehtha.

I urojmë kongresit tuaj sukses të plotë!

Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë, me shokun Enver Hoxha në krye, mban lart me vendosmëri flamurin e kuq revolucionar të marksizëm-leninizmit në kushtet e rrethimit të shumëfishtë nga ana e imperializmit dhe e revizionizmit modern.

Shqipëria popullore heroike është bërë një fener i madh ndriçues i socializmit në Evropë.

Në krahasim me ju, klika udhëheqëse revisioniste e Bashkimit Sovjetik, klika titiste jugosllave dhe klikat e renegatëve dhe grevëthyesve të ndryshëm, nuk janë gjë tjetër veçse një tog me baltë, ndërsa ju jeni një mal kreshnik. Ata janë shërbëtorë e qehallarë që bien në gjunjë para imperialistëve, ndërsa ju jeni revolucionarë proletarë sypatrembur, që guxoni të luftoni kundër imperialistëve dhe këlyshëve të tyre, kundër të gjithë armiqve të egër në botë.

Në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavi dhe në vendet e tjera ku në fuqi janë klikat e revisionistëve modernë, ka ndryshuar ose po ndryshon ngjyra, është kryer ose po kryhet restaurimi i kapitalizmit, diktatura e proletariatit është shndërruar ose po shndërrohet në diktaturë të borgjezisë. Shqipëria socialiste heroike e ka përballuar këtë rrymë regresive revisioniste kundër-revolucionare. Duke iu përbajtur vijës revolucionare marksiste-leniniste, ju keni

marrë një sërë masash revolucionarizuese dhe keni konsoliduar diktaturën e proletariatit. Duke ecur në rrugën e socializmit, ju po ndërtoni në mënyrë të pavarur Atdheun tuaj dhe keni arritur fitore të shkëlqyera. Ju keni kontribuar me një eksperiencë të çmuar në historinë e dikaturës së proletariatit.

“Kemi miq në këtë botë, me ta jemi lidhur fort, nga ata sado larg që jemi, porsi komshi të mirë i kemi”. Mijëra male dhe qindra lumenj e ndajnë Kinën nga Shqipëria, por zemrat tonë janë të lidhura ngushtë. Ne jemi miq e shokë tuaj të vërtetë dhe ju jeni gjithashtu miq e shokë tanë të vërtetë. Si ne ashtu edhe ju nuk jemi miq të rremë që nga goja nxjerrim mjaltë dhe mbajmë helmin në bark, nuk jemi njerëz me dy faqe. Miqësia jonë revolucionare e luftarake u ka rezistuar provave në stuhi e shtërngata.

E vërteta e marksizëm-leninizmit është me ne. Proletariati ndërkombëtar është me ne. Kombet e shtypura dhe popujt e shtypur janë me ne. Masat popullore, që përbëjnë mbi 90 përqind të popullsisë së

përgjithshme të botës, janë me ne. Ne kemi miq në gjithë botën. Ne nuk kemi frikë nga izolimi dhe nuk do të izolohemi kurrë. Ne jemi të pamposhtur. Një grusht njerëzish mizerabël antikinezë dhe anti-shqiptarë janë të destinuar të dështojnë.

Ne jetojmë tani në një epokë të re dhe të madhe të revolucionit botëror. Fur-tuna e revolucionit në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine do t'i japë patjetër tërë botës së vjetër një goditje shkatërruese vendimtare. Dëshmi e gjallë për këtë është fitorja e madhe e luftës që bën populli vietnamez kundër agresorëve amerikanë për shpëtimin e atdheut. Proletariati dhe punonjësit e Evropës, Amerikës Veriore dhe Oqeanisë ndodhen në një zgjim të ri. Imperialistët amerikanë dhe të gjithë parazitët e tjerë kanë pregetitur varrmihësit e tyre. Dita e varrimit të tyre nuk do të jetë e largët.

Sigurisht, rruga në të cilën ecim ne nuk mund të jetë kurrë e sheshtë e pa kthesa. Të jeni të sigurtë, shokë, se pavarësisht nga çfarëdo që të ndodhë në botë, dy partitë dhe dy popujt tanë me siguri do të që-

ndrojnë sëbashku, do të luftojnë sëbashku
dhe do të fitojnë sëbashku.

Le të bashkohen partitë dhe popujt e Kinës dhe Shqipërisë, le të bashkohen marksistë-leninistët e mbarë botës, le të bashkohen popujt revolucionarë të të gjitha vendeve për të përbysur imperializmin, për të përbysur revizionizmin modern, për të përbysur reaksionin e vendeve të ndryshme. Një botë e re pa imperializëm, pa kapitalizëm dhe pa sistem shfrytëzimi do të krijohet patjetër.

**KOMITETI QENDROR I PARTISË
KOMUNISTE TË KINËS**

**Kryetari
MAO CE-DUN**

25 tetor 1966

PËRMBAJTJA

I.	Partia komuniste	1
II.	Klasat dhe lufta e klasave	9
III.	Socializmi dhe komunizmi	24
IV.	Trajtimi i drejtë i kontradiktave në gjirin e popullit	47
V.	Lufta dhe paqa	61
VI.	Imperializmi dhe të gjithë reak- sionarët janë tigra prej letre	75
VII.	Guxim për luftë, guxim për fitore	86
VIII.	Lufta popullore	93
IX.	Ushtria popullore	106
X.	Udhëheqja e komiteteve të partisë	111
XI.	Vija e masave	126
XII.	Puna politike	143

XIII.	Marrëdhëniet midis oficerëve dhe ushtarëve	157
XIV.	Marrëdhëniet midis ushtrisë dhe popullit	162
XV.	Demokracia në tri fushat krye- sore	167
XVI.	Arësimi dhe stërvitja	175
XVII.	T'i shërbejmë popullit	180
XVIII.	Patriotizmi dhe internaciona- lizmi	185
XIX.	Heroizmi revolucionar	192
XX.	Dashuria për punën dhe fryma e kursimit në ndërtimin e vendit	197
XXI.	Mbështetja në forcat e veta dhe lufta këmbëngulëse	206
XXII.	Metoda e të menduarit dhe me- toda e punës	215
XXIII.	Hetime dhe studime	243
XXIV.	Ndreqja e mendimeve të ga- buara	251
XXV.	Uniteti	266
XXVI.	Disiplina	269
XXVII.	Kritika dhe autokritika	273

XXVIII.	Komunistët	284
XXIX.	Kuadrot	293
XXX.	Rinia	306
XXXI.	Gruaja	312
XXXII.	Kultura dhe arti	317
XXXIII.	Mësimi	323

I. PARTIA KOMUNISTE

Forca qendrore që udhëheq çështjen tonë
është Partia Komuniste e Kinës.

Baza teorike, nga e cila orientohet mendi-
mi ynë është marksizëm-leninizmi.

Fjala e hapjes në sesionin e parë
të legjislaturës së parë të Asam-
blesë Kombëtare Popullore të
Republikës Popullore të Kinës
(15 shtator 1954).

Për të bërë revolucion, duhet të kesh
një parti revolucionare. Pa një parti
revolucionare, pa një parti revolucionare të
krijuar në bazë të teorisë revolucionare
marksiste-leniniste dhe të stilit revolucionar
marksist-leninist, nuk mund të udhëhiqen
klasa punëtore dhe masat e gjera popullore

drejt fitores në luftën e tyre kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij.

«Forca revolucionare të të gjithë botës, bashkohuni, luftoni agresionin imperialist!» (nëndor 1948), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 5.

Pa përpjekjet e Partisë Komuniste të Kinës, pa komunistët kinezë, si shtyllë kurrizore e popullit kinez, nuk mund të arrihet as pavarësia dhe çlirimi i Kinës, as industrializimi dhe modernizimi i bujqësisë së saj.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedhura*, vëll. 4.

Partia Komuniste e Kinës është bërthama udhëheqëse e gjithë popullit kinez. Pa një bërthamë të tillë, çështja e socializmit nuk mund të triumfojë.

Bisedë e zhvilluar gjatë takimit me delegatët e Kongresit të 3-të të Bashkimit të Rinisë së Demokracisë së Re të Kinës (25 maj 1957).

Një parti e disiplinuar, e armatosur me teorinë marksiste-leniniste, që përdor metodën e autokritikës dhe që është e lidhur me masat populllore; një ushtri e udhëhequr nga një parti e tillë; një front unik i të gjitha klasave revolucionare dhe i të gjitha grupeve revolucionare nën udhëheqjen e një partie të tillë — ja tri armët kryesore, me të cilat ne e mundëm armikun.

«Mbi diktaturën demokratike të popullit» (30 qershor 1949), *Vepra të zgjedbura*, vëll. 5.

Ne duhet të kemi besim tek masat, duhet të kemi besim tek partia. Këto janë dy parime themelore. Në qoftë se do t'i vëmë në dyshim këto dy parime, ne nuk do të mund të bëjmë asgjë.

«Mbi çështjen e kooperimit të bujqësisë» (31 korrik 1955).

E armatosur me teorinë dhe ideologjinë marksiste-leniniste, Partia Komuniste e Kinës i solli popullit kinez një stil të ri

pune, tiparet kryesore të të cilit janë: bashkimi i teorisë me praktikën, lidhja e ngushtë me masat popullore dhe auto-kritika.

«Mbi qeverinë e koalicionit» (24 prill 1945), *Vepra të zgjedbura*, vëll. 4.

Një parti që udhëheq një lëvizje të mëdhe revolucionare nuk mund të korrë fitore pa zotëruar teorinë revolucionare, pa pasur njohuri mbi historinë dhe pa e kuptuar thellë lëvizjen praktike.

«Vendi i Partisë Komuniste të Kinës në luftën kombëtare» (tetor 1938), *Vepra të zgjedbura*, vëll. 2.

Ne kemi thënë edhe më parë, se lëvizja për ndreqjen e stilit është një “lëvizje e përgjithshme për edukimin marksist”. Ndreqje e stilit do të thotë që gjithë partia të studiojë marksizmin nëpërmjet kritikës dhe autokritikës. Gjatë kësaj lëvizjeje ne

patjetër do ta përvehtësojmë edhe më thellë marksizmin.

«Fjala e mbajtur në konferencën kombëtare të Partisë Komuniste të Kinës mbi punën e propagandës» (12 mars 1957).

Është një detyrë shumë e vështirë t'u sigurosh një jetë të mirë disa qindra miliona kinezëve, të shndërrrosh vendin tonë të prapambetur nga pikëpamja ekonomike dhe kulturale në një vend të begatshëm, të fuqishëm dhe me një kulturë të lartë. Që të mund t'i dalim në krye më me sukses kësaj detyre, si dhe që të mund të punojmë më mirë sëbashku me të gjithë njerëzit me vullnet të mirë jashtë partisë, që janë të vendosur për të kryer transformime, ne duhet të zhvillojmë lëvizjen për ndreqjen e stilit, duhet ta zhvillojmë atë si tani ashtu edhe në të ardhmen dhe të flakim tej vazhdimesht çdo gjë të gabuar që kemi.

Po aty.

Politika është pikënisja e të gjitha vepri-meve praktike të një partie revolucionare dhe manifestohet në procesin dhe rezultatet e këtyre veprimeve. Çdo veprim i një partie revolucionare është zbatim i politikës. Në qoftë se ajo nuk zbaton një politikë të drejtë, atëherë zbaton një politikë të gabuar; në qoftë se ajo nuk e zbaton në mënyrë të ndërgjegjshme një politikë të caktuar, atëherë e zbaton atë verbërisht. Ajo që ne quajmë eksperiencë, është procesi dhe rezultatet e zbatimit të politikës. Vetëm nga praktika e popullit, domethënë nga eksperienca, mund të verifikohet nëse një politikë është e drejtë apo e gabuar dhe të përcaktohet se në ç'masë ajo është e drejtë apo e gabuar. Por praktika e një-rëzve, veçanërisht praktika e një partie revolucionare dhe e masave revolucionare, nuk mund të mos lidhet me këtë apo atë politikë. Prandaj, para se të ndërmarrim ndonjë veprim, duhet t'ua sqarojmë anëtarëve të partisë dhe masave politikën që kemi formuluar në përshtatje me rrethanat. Përndryshe, anëtarët e partisë dhe

masat nuk do të udhëhiqen nga politika jonë, do të veprojnë verbërisht dhe do të zbatojnë një politikë të gabuar.

«Mbi politikën në lidhje me industrinë dhe tregëtinë» (27 shkurt 1948), *Vepra të zgjedbura*, vëll. §.

Partia jonë e ka përcaktuar vijën e përgjithshme dhe politikën e përgjithshme të revolucionit kinez, ajo ka përcaktuar gjithashtu vija të veçanta në punë dhe masa politike të veçanta. Megjithatë, ndodh shpesh që shumë shokë mbajnë mend vijat e veçanta në punë dhe masat politike të veçanta të partisë sonë, por harrojnë vijën e përgjithshme dhe politikën e përgjithshme të saj. Në qoftë se me të vërtetë e harrojmë vijën e përgjithshme dhe politikën e përgjithshme të partisë sonë, ne do të jemi revolucionarë të verbër, revolucionarë të paformuar, me mendime të turbullta dhe, kur të zbatojmë një vijë të veçantë në punë dhe masa politike të veçanta, ne do të humbasim orientimin, do të anojmë herë